



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.288/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së tavolinës me materjal zgjedhor në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Nisma për Kosovën me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materjalit zgjedhor në rrugë publike.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se me datën 29.shtator.2017 aktivistet e LLV-së në Prishtinë kanë vërejtur se në Sheshin Skenderbeu në Prishtinë është vendosur një lloj tavoline me material zgjedhor të subjektit politik Nisma. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik Nisma ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se subjekti politik Nisma për Kosovën ka vendosur në rrugë publike një tavolinë me materjal zgjedhor, paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi pasi që nga fotografit që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe të sigurt shkelja e pretenduar.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që ti vërtetoj pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.288/2017 më datën 20.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.